

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: ZVOGËLIMI I PABARAZIVE

Zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve.

Target: Objektivi 10.4

10.4 Të miratohen politika, sidomos ato fiskale, politika të pagave dhe të mbrojtjes sociale, dhe të arrihet në mënyrë progresive barazi më e madhe.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 3

Konventa për Eliminimin e
të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e
të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas

Shtetet palë do të marrin t? gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat,
sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe
legjislacionin, për të siguruar zhvillimin e plot? dhe p?rparimin e grave me qëllim
që t'u garantojn? atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave e të lirive themelore t?
njeriut mbi bazën e barazisë me burrat.

1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e zënjës punë, për të siguruar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, të drejtat e njëjta, e sidomos:

(a) Të drejtën për punë si një e drejtë e pamohueshme e të gjithë njerëzve;

(b) Të drejtën për mundësi të njëjta punësimi, duke përfshirë zbatimin e kriterëve të njëjta të përzgjedhjes lidhur me zënjën punë;

(c) Të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për ngritjen e postit të punës, për punë të qëndrueshme, për të gjitha përfitimet dhe kushtet e punës, të drejtën për përgatitje profesionale dhe rikualifikim, duke përfshirë mësimin e personave në ekonomi, ngritjen profesionale dhe kualifikimin e herëpëherëshëm;

(ç) Të drejtën për shpërblim të barabartë, duke përfshirë shpërblimet ndihmë dhe për trajtim të barabartë për punën me vlerë të barabartë, si dhe për barazinë e trajtimit në vlerësimin e cilësisë së punës;

(d) Të drejtën për sigurime sociale, sidomos në rastet e pensionimit, të papunësisë, të sëmundjes, të invaliditetit dhe të pleqërisë ose të çdo humbje tjetër të aftësisë për punë, si dhe të drejtën për pushime të paguara;

Konventa për Eliminimin e
të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e
të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas

(dh) Të drejtën për mbrojtjen e shëndetit dhe për sigurimin në punë, duke përfshirë ruajtjen e funksionit biologjik dhe riprodhues të gruas.

2. Për të parandaluar diskriminimin ndaj gruas për shkaqe martesore ose maternitetit, dhe për të siguruar të drejtën e saj efektive për punë, shtetet palë marrin masa të përshtatshme:

(a) Për të ndaluar pushimin nga puna për shkaqe shtatzanie apo të lejes së barrës, si dhe diskriminimin në raste të pushimit nga puna të bazuar në gjendjen martesore, në kërkesimin e marrjes së sanksioneve;

(b) Për të aplikuar leje të barrës me pagesë ose për të përfituar ndihma sociale të krahasueshme, pa e humbur vendin e mëparshëm të punës, të të drejtave të vjetërsisë dhe të avantazheve sociale;

(c) Për të inkurajuar sistemin e shërbimeve sociale mbështetëse të nevojshme që t'i mundësojnë prindërit të gërhojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë në vendin e punës, dhe të marrin pjesë në jetën publike, sidomos duke nxitur themelimin dhe zhvillimin e një rrjeti çerdhesh e kopshtesh;

(ç) Për të siguruar një mbrojtje të veçantë për gratë shtatzëna në ato vende të punës në të cilat provohet se puna që kryejnë është e dëmshme.

3. Masat e mbrojtjes ligjore të grave në çështjet e përfshira në këtë nen do të rishikohen periodikisht varësisht nga njohuritë shkencore e teknike. Këto masa, sipas nevojës, do të rishikohen, shfuqizohen ose zgjerohen.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 13

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në fusha të tjera të jetës ekonomike dhe sociale, në mënyrë që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrave dhe grave, të njëjtat të drejta, në veçanti:

- (a) E drejta për përfitime familjare;
- (b) E drejta për kredi bankare, hipoteka dhe forma të tjera të kredisë financiare;
- (c) E drejta për të marrë pjesë në aktivitete rekreative, sporte dhe të gjitha aspektet e jetës kulturore.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

Neni 14.2.a

Të marrë pjesë në përpunimin dhe zbatimin e planifikimit të zhvillimit në të gjitha nivelet;

Neni 2

2

Shtetet Palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format e saj, bien dakord të ndjekin me të gjitha mjetet e duhura dhe pa vonesë një politikë të eliminimit të diskriminimit ndaj grave dhe, për këtë qëllim, të ndërmarrin:

2.a

Të mishërojë parimin e barazisë së burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose legjislacionin tjetër të duhur, nëse ende nuk është i përfshirë në të dhe të sigurojë, përmes ligjit dhe mjeteve të tjera të përshtatshme, realizimin praktik të këtij parimi;

2.b

Të miratojë masa të duhura legjislative dhe të tjera, përfshirë sanksione kur është e përshtatshme, duke ndaluar çdo diskriminim ndaj grave;

Neni 22

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë sigurimi social dhe të drejta të domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit të tij, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 23

1. Secili ka të drejtë të punoj?, të zgjedhë lirisht punën, të ketë kushte të kështuqësi dhe të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

2. Secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë rrogë të barabartë.

3. Secili që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe që, po qe se është e nevojshme, do të plotësohet me mjete të tjera të mbrojtjes sociale.

4. Secili ka të drejtë të formojë e t'u bashkohet sindikatave për mbrojtjen e interesave të tij.

Neni 25 para 1

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

1. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Neni 4.2

2. Palët angazhohen që të miratojnë, kurdoherë që është e nevojshme, masa të përshtatshme me qëllim që të nxisin, në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Lidhur me këtë, ata do të marrin parasysh në mënyrën e duhur kushtet e veçanta të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës
Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Neni 2.1

1. Shtetet palë respektojnë dhe i sigurojnë të drejtat e përcaktuara në këtë Konventë çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paafërsia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë,

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 19

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 4

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 26.1

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

26.1

Shtetet Palë do të njohin për çdo fëmijë të drejtën të përfitojnë nga sigurimet shoqërore, duke përfshirë sigurimet shoqërore, dhe të marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar.

Neni 26.2

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

26.2

Përfitimet duhet të jepen, kur është e përshtatshme, duke marrë parasysh burimet dhe rrethanat e fëmijës dhe personave që kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e fëmijës, si dhe çdo konsideratë tjetër e rëndësishme për një kërkesë për përfitime të bëra nga ose në emër të fëmijë.

Ligjet

Nenet

Neni 3

LIGJI NR. 06/L-111
PËR PAGAT NË
SEKTORIN PUBLIK
LIGJI NR. 06/L-111
PËR PAGAT NË
SEKTORIN PUBLIK

1. Pagat bazohen sipas parimeve të përcaktuara me këtë ligj, si vijon: 1.1. parimi i ligjshmërisë - nënkupton që pagat e përfituesve përcaktohen vetëm në pajtim me këtë ligj dhe me aktet nënligjore, të autorizuar dhe të nxjerra në zbatim të tij; 1.2. parimi i drejtësisë – nënkupton që niveli i pagës duhet të shpërblejë në mënyrë të drejtë kompleksin e punës dhe kontributin e individit në punën e organizatës; 1.3. parimi i pagës së barabartë - nënkupton që secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë apo të krahasueshme; 1.4. parimi i transparencës – nënkupton që procedura për përcaktimin e pagës, niveli i saj dhe administrimi i sistemit të pagave të jetë transparente për publikun, pa rënë në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi; 1.5. parimi i mosdiskriminimit - nënkupton që asnjë përfitues i pagës nuk diskriminohet në pagë, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; 1.6. parimi i parashikueshmërisë – niveli i pagës, i përcaktuar sipas këtij ligji, nuk mund të ulet, përveç në një situatë të jashtëzakonshme të vështirësive financiare dhe vetëm në bazë të ligjit.

LIGJI Nr. 04/L-62
PËR FSHATIN
HOÇË E MADHE,
GAZETA
ZYRTARE E
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS / Nr. 20 /
LIGJI Nr. 04/L-62
PËR FSHATIN
HOÇË E MADHE,
GAZETA
ZYRTARE E
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS / Nr. 20 /

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të fshatit Hoçë e Madhe si pronë e trashëgimisë kulturore dhe fetare në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur.

LIGJI Nr. 04/L-62
PËR FSHATIN
HOÇË E MADHE,
GAZETA
ZYRTARE E
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS / Nr. 20 /
LIGJI Nr. 04/L-62
PËR FSHATIN
HOÇË E MADHE,
GAZETA
ZYRTARE E
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS / Nr. 20 /

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë ligj përcaktohet e drejta e autoritetit të kufizuar e Fshatit Hoçë e Madhe për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare si dhe te planifikimit rural në pajtim me ligjet në fuqi.